



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVË -SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	01/B
Nr. Prot. Broj Prot.	630
Nr. i faqeve Br stranica No. pages	2
Datum: 23.09.2021	
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija Ministry of
Education, Science, Technology and Innovation

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B / 24

Data: 23.04.2021

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të nenit 26 paragrafit 1 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, nenit 28 paragrafi 1 nënparagrafi (e), nenit 3 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve, nenit 22 dhe nenit 47 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3, nenit 5 dhe nenit 8 paragrafi 6.3 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 3 të Ligjit nr.03L/068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, mars 2019), nenit 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4, Shtojca 1 paragrafi 7 i Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 30. 03. 2021 dhe nenit 9 paragrafi 7 të Udhëzimit administrativ (MASH) nr. 85/2020 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2020/2021, nxjerr këtë:

VENDIM

Për organizimin e mësimit alternativ të përshpejtuar për 441 nxënësit e Komunës së Kamenicës

1. Kompensohen orët e humbura përmes organizimit të mësimit alternativ të përshpejtuar për nxënësit e nivelit të arsimit fillor (I-V) dhe nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të ulët (VI-IX);
 - 1.1. Nxënësit e paraleles fizike në fshatin Shipashnicë e Poshtme;
 - 1.2. Nxënësit e paraleles fizike në fshatin Kopernicë;
 - 1.3. Nxënësit e SHFMU “Hasan Prishtina” në Busavatë;
 - 1.4. Nxënësit e SHFMU “Asllan Thaqi” në fshatin Karaçevë e Poshtme;
 - 1.5. Nxënësit e SHFMU “Xhelal Sopi” në fshatin Petrocë.
2. Themelohet komisioni në kuadër të MASHTI-t për hartimin e përmbajtjes mësimore për organizimin e mësimit alternativ të përshpejtuar për nxënësit sipas pikës 1 të vendimit.
3. Mësimi alternativ i përshpejtuar për nxënësit sipas pikës 1 të këtij vendimi, zhvillohet nga mësimdhënësit e Komunës së Kamenicës.

4. Orari mësimor përgatitet në mënyrë që mësimdhënësit që do të punojnë me nxënësit sipas pikës 1 të vendimit, të mos pengohen nga orari i mësimit që janë duke e zhvilluar në shkollat tjera të caktuara nga komuna.
5. Obligohet DKA në Kamenicë të sigurojë kushte optimale dhe furnizimin me materiale mësimore për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor për nxënësit sipas pikës 1 të vendimit.
6. Inspektorati i Arsimit në Republikën e Kosovës obligohet që të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të akteve juridike në fuqi dhe të këtij vendimi, me qëllim të krijimit të kushteve për funksionimin e rregullt dhe të papenguar të procesit edukativo-arsimor.
7. Procesi mësimor zhvillohet në objektet shkollore më të afërta dhe në pajtim me rekomandimet e MASHTI, MSH dhe IKSHPK-së.
8. Task forca në nivel të shkollës e themeluar sipas vendimit me nr. 01B-101 të datës 11.09.2020, sigurojnë që institucionet edukativo-arsimore kanë krijuar të gjitha kushtet për rifillimin e procesit mësimor.
9. Mësimi i përsheptuar plotësues do të fillojë më 4 maj 2021.
10. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, obligimin e MASHTI-t për të garantuar të drejtën për arsim, rekomandimet e raportit të datës 14.04.2021 mbi nevojën për kompensimin e orëve të humbura nga ana e 441 nxënësve në Komunën e Kamenicës të Komisionit ad-hoc, i themeluar në bazë të vendimit 01B/14, raportet e Inspektoratit të dt. 14.09.2020 me ref:10 me nr.239, 14.01.2020, nr.10/3 me nr. Prot. 004/20, 29.03.2021, ref:10/nr. 233, 30.03.2020, ref: 10/nr.237, u vendos si në dispozitiv të vendimit.

Vendimi i dorgohet:

1. Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Kamenicës;
2. Kabinetit të Ministrit/MASHTI;
3. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. Departamentit të arsimit parauniversitar/MASHTI;
5. Inspektoratit të arsimit;
6. Arkivit/MASHTI.

MASHTI

Arbërie Nagavci

Arbërie Nagavci, ministre e MASHTI

